

Në bazë të nenit 8, pika 1 e Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A me datë 18/03/2024 shpall këtë:

## K O N K U R S PËR PRANIMIN E PUNËTORËVE SEZONAL

Shpallim plotësimin e vendeve të lira të punës për pozitat:

- Poz.1:** Një (1) Ujtar - Regjistruar (Për regjistrime të kulturave në terrenet që mbulon NO"Xërxe" )  
**Poz.2:** Një (1) Ujtar - Regjistruar (Për regjistrime të kulturave në terrenet që mbulon NO"Lugbunar" )  
**Poz.3:** Një (1) Ujtar - Regjistruar (për punë terreni në Njësinë Operative "Dukagjini" në Prizren)  
**Poz.4:** Një (1) Rojtar për punë sezonale në Njësinë Operative "Dukagjini" në Prizren  
**Poz.5:** Një (1) Operator në digën G2 në Tabakhane

### Detyrat për pozitën e ujtarit - regjistruar

- Kujdeset për gypsjiellësat, avaritë, shfrytëzimin e ujit. Intervenon në eliminimin e avarive dhe manipulon me mekanizmat për ndërprerjen dhe lëshimin e ujit në rrjetin e ujitjes
- Përpilon regjistrin e kulturave dhe sipërfaqeve të ujitura
- Pengon dhe me kohë informon për shfrytëzimin ilegal të ujit dhe kyçjet ilegale
- Kryen edhe punë të tjera sipas nevojave të Kompanisë me urdhër të udhëheqësit

### Detyrat për pozitën e rojtarit

- Kujdeset dhe ruan objektet, materialin e deponuar në objekte të mbyllura në depo. Ruan materialin e deponuar në hapësirat jashtë objekteve-depove. Në raste të vërejtjes së rrezikut nga zjarri apo rreziqeve të tjera ,merr masat më efektive dhe menjëherë kërkon ndihmë për evitimin e tyre.

### Detyrat për pozitën e operatorit të digës

- Manipulon me ujin në digë
- Punon në mirëmbajtjen, ruajtjen dhe pastrimin e digës dhe objekteve në kanal (pastrimii grilave, bankinave, mirëmbajtja e rrugëve përgjatë kanalit si dhe punë tjera që i jep udhëheqësi i tij)
- Kujdeset për ruajtjen e pajisjeve dhe materialit ndërtimor

### Kualifikimi:

- Për të gjitha pozitat kandidatët preferohet t'a kenë të kryer shkollën e mesme.

### Kushtet:

- Të ketë përvojë në punë dhe në detyra të ngjajshme
- Të jenë në gjendje që t'i kryejnë detyrat e punës me përgjegjshmëri
- Të jenë në gjendje të punojnë nën presion dhe jashtë orarit të punës
- Të kenë aftësi komunikimi, raportimi dhe përshtatshmërije në punë ekipore.

### Procedura e aplikimit dhe dokumentacioni i nevojshëm:

- Kërkesa dhe CV
- Diploma përkatëse, certifikatat e trajnimeve
- Dëshmi mbi përvojën në punë(nëse ka)
- Certifikata e lindjes dhe kopja e letërnjoftimit
- Dëshmi të mos të jenë të dënuar dhe nën hetime

✓ *Kandidatët e interesuar mund t'a dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në ndërtesën administratës së Drejtorisë së Kompanisë Regjionale të Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A që gjendet në Gjakovë, rruga e UÇK-së. p.n.*

*Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.*